



Prishtinë, 10. 12. 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1330_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e nenit 8, paragrafët 1 dhe 6, të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e nenit 15 dhe nenit 26 paragrafi 1, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Rregullën dhe Metodologjinë për Hartimin e Balanceve të Energjisë; dhe
- Kërkesën e Ndërmarrjes Publike - Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Termokos sh.a. të datës 05 Nëntor 2020, për miratimin e dokumentit: Bilanci Vjetor i Energjisë Termike për vitin 2021.

Pas shqyrtimit të dokumentit në fjalë dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur me datë **10.12.2020**, nxori këtë:

VENDIM

I. APROVOHET BILANCI VJETOR I ENERGISË TERMIKE për vitin 2021 i NP Termokos sh.a.

Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar draftin final të dokumentit: Bilanci Vjetor i Energjisë Termike për vitin 2021 nga NP Termokos sh.a. si bartës i Licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë termike.
 2. Pas shqyrtimit të draft-dokumentit “Bilanci Vjetor i Energjisë Termike - 2021” të dorëzuar nga NP Termokos dhe përmirësimit e plotësimit të tij sipas komenteve të ZRRE-së, Bordi i ZRRE -së duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Obligohet i licencuari që pas pranimit të këtij Vendimi menjëherë të publikojë dokumentin “Bilanci Vjetor i Energjisë Termike - 2021” në faqen elektronike zyrtare të tij.
 - III. Duke pasur parasysh ndikimin e parametrave të ndryshëm të bilancit në përcaktimin e tarifave, ZRRE mban të drejtën që gjatë shqyrtimit tariforë të përshtatë të dhënat që përmban Bilanci vjetor i energjisë termike.
 - IV. Në zbatim të nenit 42, paragrafi 2.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) do të monitoroj implementimin e Bilancit Vjetor të Energjisë Termike për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në këtë Bilanc.



V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së.

VII. Ky Vendim publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku gjithashtu do të publikohet edhe Bilanci unik i energjisë elektrike dhe energjisë termike.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së


Arsim Janova, UD Kryesues


Besim Beqirijaj, Anëtar


Selman Hoti, Anëtar


Izet Rushiti, Anëtar

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

Bilanci Vjetor i Energjisë Termike – 2021, NP Termokos

Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së